



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ (MPL)nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme dhe komitetve tjera në Komunë, nenit 20 par. 20.1, 33 dhe 34 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kërkon nga Kuvendi i Komunës që në mbledhjen e datës 31.01.2022 të miratojë këtë:

V E N D I M

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa

Me këtë Vendim, zëvendësohet anëtarja e komitetit për politikë financae znj. Hyra Bytyqi e caktuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 15Nr.020-78081 të datës 24.12.2021, në numrin rendor 2 nga subjekti politik LDK përshkak të ndërrimit të funksionit publik dhe në vend të saj ÇAKTOHET, Albiona Tasholli nga subjekti i njëjtë politik-LDK-ja.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara me dispozitat e neneve 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 33 dhe 34 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 15Nr.020-78081 të datës 24.12.2021.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

15 Nr. 020-6048
Lipjan, më 31.01.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

